

# STATUT

## (I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR) "HANI I PAZARIT" sh.p.k.

### Baza Ligjore.

Në këtë statut:

- "Ligji", është Ligji Nr: 9901, dt: 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- "Statuti", është Statuti i Shoqërisë;

## KREU I

### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA.

#### Neni 1

##### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1-Sot më datë 04.02.2021, ne, ortakët e shoqërisë, **Xhemal PONARI** dhe **Filip FERMANIS**, kemi miratuar Statutin të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin: "**HANI I PAZARIT**" sh.p.k, bazuar në Ligjin Nr: 9901, datë 14.04.2008, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*".

2-Themelues të shoqërisë janë:

1 **Xhemal PONARI**, i biri i Sherifit, i datëlindjes 03.04.1956, banues në Tiranë, Shqipëri, me adresë, rruga "Qemal Stafa", pallati 01, Shkalla 09/36, mbajtës i kartës së identitetit me numër ID: F60403113G;

2 **Filip FERMANIS**, i biri i Kristaqit, i datëlindjes 14.01.1985, banues në Korçë, Shqipëri, me adresë, lagjia 04, rruga "Aspasi Gjino", Objekti 09, Ap: 09, mbajtës i kartës së identitetit me numër ID: I50114059J;

#### Neni 2

##### Objekti

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në:

- Hoteleri;
- Bar-Kafe;
- Restorant;

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### Neni 4

#### Selia, Adresa Elektronike

Selia e shoqërisë private "HANI I PAZARIT" sh.p.k është:

Korçë, Lagjia 8, Sheshi "Liria", Objekti nr:77, Korçë

E-mail: [filipfermanis@yahoo.com](mailto:filipfermanis@yahoo.com)

Nr/Telefoni: (+355) 69 33 43 613

## KREU II

### KAPITALI I REGJISTRUAR

### Neni 5

#### Vlera dhe Pagesat e Kapitalit të Rregjistruar

(1)Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë " HANI I PAZARIT " sh.p.k është 100'000 lekë.

Pjesëmarrja në kapitalin e themeluesve të shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre të mëposhtëm:

<b>1- Xhemal PONARI</b>	Numëri i kuotave:	=	<b>1</b>
	Pjesët e zotërimit të kapitalit:	=	<b>60, %</b>
	Vlera e pjesëve:	=	<b>60'000, lekë</b>

<b>2- Filip FERMANIS</b>	Numëri i kuotave:	=	<b>1</b>
	Pjesët e zotërimit të kapitalit:	=	<b>40, %</b>
	Vlera e pjesëve:	=	<b>40'000,</b>
<b>lekë</b>			

-Vlera totale e kapitalit të regjistruar = 100'000, lekë

-Numëri Total i kuotave = 2.

(2)Kontributet në para janë paguar plotësisht dhe menjëherë.

## Neni 6

### Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

(1) Administratorët mund t'i kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 ditësh të plota në të cilën përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë Shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij prej kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

(3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatvonesë prej 4% në vit duke filluar nga data e parashikuar për pagesën.

(4) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojë paraprakisht të paktën 14 katërmbëdhjetë ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer bashkë me kamatvonesat. Njoftimi do të përmbajë vendin ku do të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast mos zbatimi të tij, kuotat të cilave i'u referohet njoftimi do të anulohen.

(5) Në se pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilën lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

(6) Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar do të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe menyrave që Administratorët konsiderojnë të pershtatshme.

(7) Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyhen nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.



## Neni 7

### Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat në fuqi të ligjit dhe parashikuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat egzistuese, kuotat do të emtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në Vëndimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar <sup>3</sup>/4 të votave të ortakëve, në përputhje me Nenin 87 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## Neni 8

### Çertifikimi i kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij, Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje të pikës 2 të nenit 72 të Ligjit 9901 datë 14.04.2008.

Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës. Çertifikata nuk do të ketë cilësinë e letrës me vlerë.

## Neni 9

### Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve, në proporcion me % e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

1-Kuotat e kapitalit të një SHPK-je dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen ose kalohen nëpërmjet:

- a-kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b-shitblerjes,
- c-trashëgimisë,
- d-dhurimit
- e-çdo forme tjetër të parashikuar me ligj.

2-Kur kalimi i kuotave do bëhet me kontratë, kontrata do bëhet me shkrim midis palëve.

**Kalimi i kuotave do të jetë i lirë, por me të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë\***



## Neni 10

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

(1)-Zmadhimi i kapitalit do të bëhet me shumicë të kualifikuar votash prej  $\frac{3}{4}$  nga Asambleja e Përgjithshme (AP).

Zmadhimi i kapitalit Themeltar mund të bëhet dhe duke rritur kuotat e ortakëve.

Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet dhe me pranimin e ortakëve të rinj por gjithmonë me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave.

(2)-Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar do të bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme me shumicë të kualifikuar prej  $\frac{3}{4}$  të votave.

## Neni 11

### Blerja e kuotave të veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta vetëm nëse përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të ligjit 9901 datë 14.04.2008.

Në rastin e blerjes së kuotave të veta shoqëria duhet të veprojë në përputhje me **nenin 77** të Ligjit, në të kundërt paditë mbi përgjegjësin e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me **nenin 78 dhe 79 të Ligjit 9901** datë 14.04.2008.

## KREU III

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME (AP)

## Neni 12

### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme (AP)

(1)Administratoret therrasin Asamblyne e Përgjithshme dhe me kërkesën e ortakëve të pakicës sipas një rasti të përcaktuara në pikat e **Nenit 84**.

(2)Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike drejtuar çdo ortaku ose dhe përfaqësuesve të kuotave me zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik do të përmbajë vendin, datën ,orën e mbledhjes jo më vonë se **7 ditë** përpara datës së parashikuar të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

(3) Kur Asambleja thirret sipas pikës (1) të nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime për parregullsitë.

## Neni 13

### Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme do të marrë vendime të vlefshme, me arritjen e kuorumit të parshikuar në Nenin 86 të ligjit 9901.

Ortakët ose përfaqësuesit mund të marrin pjesë në votim dhe me mjete elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio- video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit 9901. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që i'u është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratorët caktojnë Kryetarin e Mbledhjes dhe një person për të mbajtur Proçes verbalin.

(3) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Administratori dhe pse nuk është ortak ka të drejtë të marrë pjesë aktive në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme.

Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do t'i degohet gjithë ortakëve jo me vonë se shtatë ditë përpara datës së caktuar dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

(6) Asambleja do të vendosë me votim të hapur, me përjashtime të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyren e duhur një votim i fshehtë.

Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga;

a-Kryetari

b-Një ortak ose ortakë që përfaqësojnë te pakten 10% të kapitalit themeltar.

Kërkesa e bërë nga një përfaqësues ortaku ka të njëjtën vlerë si të ishte bërë nga vetë ortaku.

(7) Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku , deklarimi i kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe rregjistrimi përkatës në proces verbalin e mbledhejes përbën provën përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër këtij vendimi.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numërimit të votave pro dhe kundër këtij vendimi.

## Neni 14

### Votat e Ortakëve

(1) Në përputhje me të drejtën apo kufizimet që rrjedhin nga kuotat, **çdo kuotë i jep ortakut** (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, **të drejtën e një vote**.

(2) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

## Neni 15

### Votimi me Prokurë

(1) Përfaqësuesi do të emrohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme:

Shoqëria "....." sh.p.k.

Unë i nënshkruari....., në cilësinë e ortakut/ortakeve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj.....me ose në pamundësi të tij në cilësinë e përfaqësuesit për të votuar në emrin tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më...../...../20..... Dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

(2) Në rastet kur do të dëshirohet t'u jepet ortakve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesit në mënyrën e veprimt, caktimi i përfaqësuesit do të bëhet sipas formës së mëposhtme;

Unë i nënshkruari ....., në cilësinë e ortakut/ortakeve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/emërojmë....., ose në pamundësi të tij,..... në cilësinë e përfaqësuesit tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e shoqërisë e cila do të mbahet më...../...../20..... dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Kjo formë do të përdoret dhe në vendimet e përmenduar më poshtë.

(3) Shoqëria caktimin e përfaqësuesit do t'a bëjë me shkrim ose një kopje të noterizuar apo miratuar nga Administratori dhe të depozitohet në Selinë e shoqërisë ose dhe në një vend tjetër por brenda territorit të Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin e Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme. Ky akt do të depozitohet 48 orë para mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

(4) Në rast se ky akt i emërimi të përfaqësuesit do të bëhet elektronik (e-mail) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti, ky akt do të merret jo më vonë se 48 orë përpara ose së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në të cilën do të votojë përfaqësuesi.

## Neni 16

### Përrjashtimi nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendimin për:

- a -vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b- shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c- ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
- d- dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 17

### Hetimet e posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për emërimin dhe zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas **nenit 91** të ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozimitit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat, plotësojnë kushtet për kryerjen e veprimit.

## KREU IV

### ADMINISTRATORËT

## Neni 18

### Emërimi i Administratorëve

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. (QKB)

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të Nenit 207 të Ligjit 9901, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar



e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë, deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

**Administratore dhe Përfaqësuese Ligjore e shoqërisë do të jetë:**

**Znj. Luiza (Andrea) FERMANIS**

**Afati i emërimit: 5 vjet me të drejtë ripërtëritje**

Të dhënat e identifikimit  
(emër, atësia, mbiemër, adresa, etj):

Specimenët e Nënshkrimit:

**1) Luiza (Andrea) FERMANIS,**

**-E datëlindjes:** 19.04.1985;

**-Me adresë:** Lagjia 04, rruga "Sotiraq Vangjel", Korçë;

**-Numër Kartë ID:** I554191071;

**-Email:** liza\_bode@hotmail.com;

**-Telefon:** (+355) 69 527 3137;



Kryetare e mbledhjeve të Administratorëve deri në zgjedhjen nga mbledhja e parë e zakonshme.

## Neni 19

### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

a- kryejnë të gjitha veprimet e adminstrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asmbleja e Përgjithshme.

b- përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

c- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë;

ç- përgatisin, nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së

veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve , i paraqesin këto

dokumenta përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;

d- krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe egzistencën e shoqërisë;

dh- kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për QKB; (Qëndrën Kombëtare të Biznesit).



e- raportojnë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me politikën tregtare të zbatuar dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë- kryjnë çdo detyrë tjetër të ngarkuar me ligj dhe statut;

Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme egziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim;
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë që rezulton në pasqyrën e fundit financiare të çertifikuar;
- Shoqëria Brenda 2 viteve të para propozon të blerë nga një ortak pasuri. Që kanë vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrën e fundit financiare të çertifikuar;

Në se Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator,  
**Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë votash të zakonshme.**

Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 20

### Përfaqësimi

(1) Kufizimet e të drejtave të përfaqësimit të administratorëve i kundër drejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligjit 9901 dt. 14.04.2008

(2) Administratorët, që përfaqësojnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.

(3) Të drejtat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen pranë **Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)**

(4) Administratorët mund t'i delegojnë kompetencat tyre çdo komiteti i cili përbehet nga një ose më shumë administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin administratorët dhe mund të revokohen ose ndryshohen.

Administratorët mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

## Neni 21

### Skualifikimi dhe shkarkimi i Administratorëve

Detyra e Administratorit përfundon në rast se;

1- Personi nuk është më administrator sipas parashikimeve të ligjit përfshirë edhe parashikimet e

pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;

2- Personi gjendet në gjëndje paaftesie paguese;

3- Personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;

4- Personi jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë ,ose

5- Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj rradhazi pa lejen e administratorit në mbledhjet e **Asamblesë së Përgjithshme** të mbajtur gjatë kesaj periudhe , dhe **Asambleja e Përgjithshme**, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

## Neni 22

### Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve

(1) Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga **Asambleja e Përgjithshme** në përputhje me nenet 97 të ligjit 9901 dt: 14.04.2008.

(2) **Asambleja e Përgjithshme** mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qënë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qënë shoqëri të kontrolluara ose një shoqëri paraardhëse të shoqërisë egzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre ose persona që janë ose ishin në varësi të tyre dhe mund të paguajnë kontribute në fonde të caktuara për dhenien e përfitimeve të tilla

(3) Administratorëve mund t'u paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit,dhe shpenzimeve të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në Mbledhjen e Administratorve ose Komiteteve të Administratorve ose të **Asamblesë së Përgjithshme** në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

## Neni 23

### Mbledhja e Administratorëve

(1) Mbledhja e administratorëve do të mbahet sipas nevojave dhe problemeve që dalin gjatë aktivitetit tregtar.

(2) **Asambleja e Përgjithshme** cakton kryetarin e administratorve.



(3) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave pjesëmarrëse. Në rast numurimi të votive, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(4) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(5) Çdo vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

## Neni 24

### Kufizimet ne Votimet e Administratorëve

(1) Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilat këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të ligjit 9901, deri në momentin kur në mbledhjen e **Asamblesë së Përgjithshme** të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që;

- të autorizojnë lidhjen e kesaj marrëveshje dhe
- të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet në **Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)**.

(2) Vota e administratorit nuk do të numërohet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë. Në këto raste do të zbatohen dhe dispozitat e Nenit 89 të Ligjit: "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" lidhur me përjashtimin e Administratorit nga vendimet e marra në këtë mbledhje.

(3) Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

## Neni 25

### Proçes verbalet e Mbledhjes së Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen proçesverbalet e;

1-të gjithë takimeve të kryera nga administratorët

2-të gjitha mbledhjeve të **Asamblesë së Përgjithshme**, mbledhjeve të administratorve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

## KREU V

### DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

## Neni 26

### Dividentët

(1) Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilën paguhet dividenti; Të gjithë dividentët pjestohen dhe paguhen në përpjestim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesë ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividenti; Në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividenti do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë divident ose pagesë në para që lidhet një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë.

(4) Çdo divident që nuk është kërkuar të paguhet brenda 12 vjeteve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë e detyruar që të paguajë atë.



## Neni 27

### Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit 9901, mund të vendosin të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë të preferuar apo shuma të tjera të parshikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

## KREU VI

### PRISHJA DHE NJOFTIMET

#### Neni 28

##### Prishja dhe likuidimi

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.) priset;

a -kur mbaron kohëzgjatja e parshikuar në themelimin e saj;

b -me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme (AP);

c -me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç -ne se nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i

veprimtarisë në përputhje me piken 3 të nenit 43 të ligjit 9723 dt 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" (QKB);

d -me Vendim të Gjykatës;

Prishja e Shoqërisë Tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e e zakonshme të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese janë në Nenet 191 deri 203 të ligjit 9901.



## Neni 29


### Njoftimet

- (1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas Statutit duhet të jenë zakonisht me shkrim ose (në se zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas **pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti** dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- (2) Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e rregjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike të tij (në se ka hapur) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkë zotërues të një kuote të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit 9901.
- (3) Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikimet, dhe proces verbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet në faqen e Internetit të shoqërisë në një kohë sa më të afërt që të jetë e mundur sipas parshikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statut

#### Ortakët Themelues:

#### Nënshkrimi

1. XHEMAL PONARI;



2. FILIP FERMANIS;



Korçë më: 04/02/2021"